



BIBLIOTEKA

8SH-32  
A58



Tasim T. Aliaj

# MURET E PAMPO SHTURA



891.983-32

A 58 BIBLIOTEKA E RINISE

TASIM T. ALIA

MURET  
E PAMPOSHTURA

— NOVELE —

~~41284~~

SHTËPIA BOTONJËSE NAIM FRASHËRI  
RINAJA DITËT

44

SHTËPIA BOTONJËSE «NAIM FRASHËRI»



shirita qëndroj e tundë mëdha si mbretëri i Sulltanit që  
tëpër qëndroj e tundë mëdha si mbretëri i Sulltanit që  
tëpër qëndroj e tundë mëdha si mbretëri i Sulltanit që  
tëpër qëndroj e tundë mëdha si mbretëri i Sulltanit që  
tëpër qëndroj e tundë mëdha si mbretëri i Sulltanit që

Tenda e Sulltanit vetëtinte si ylberi. Nga brënda ajo qe veshur me cohë të kuqe të thellë dhe me shirita tepër të kaltër. Përsipër i qe hedhur një atllas i shkëlqyer damasku. Thekët e mëndafshta, që të verbonin nga shkëlqimi, vareshin poshtë dhe tundeshin lehtë nga flladi.

Sulltanëve u dukej sikur vinin në këtë botë që kush e kush të stoliste sa më mirë tendat mbretërore. Dhe tendat ngriheshin pas shijes së Sulltanit, mbretëronin sipas së thënës, pastaj frynte era dhe sérish çthureshin njëloj! . . .

Tendën e Sulltanit e qarkonte ushtria më e madhe në Evropë dhe Azi, ushtria më e madhe në gjithë botën. Ish një ushtri pa ndonjë numër të saktë, e përbërë nga kombe të shumtë. Ish si një pyll i dendur, ku s'merret vesh se ç'lloj drurësh mpleksen e ngushtojnë njëri tjetrin.

Çdo gjë shkëlqente brënda e rreth tendës së Sulltanit. Po brënda saj punët shkonin për lumë: Sulltani rënkonte... Sulltani ish sëmurë... Netët e verës janë të shkurtëra, tepër të shkurtëra. Po Sulltanit të sëmurë netët e verës i dukeshin gjata, tepër të gjata.

Hordhitë turke kishin rrëthuar Kruiën nga katër anët. E kishin rrëthuar aq dendur, me egërsi, sa pandehej se as zogjtë nuk kalonin

Muret e lashta rriheshin ditë e natë nga topat më të fuqishëm të kohës. Sulmet e tërbuara të turqve nisnin pa dalë mirë dielli dhe priteshin kur errej! Pastaj fillonin të tjera sulme, të tjera tmere. Në kampin pa anë futeshin si kordha vigane shpatat arbërore. Skënderbeu sulmonte aty ku nuk pritej. Në njerën anë bëhej zhurmë dhe në tjetër anë kampi lahej në gjak dhe mbushej me kufoma. Thonë se kasapi pret e ndan aq më mirë, sa më i madh e sa më i majmë të jetë mishi.

Po këto ngjarje duhej t'i fshiheshin Sulltanit. Por ujkut plak vështirë t'ja fshehësh plagët. S'ke si ja fsheh plagët njeriut, i cili gjatë gjithë jetës së tij s'ka bërë gjë tjetër veçse ka hapur plagë...

Sulltani sa vinte e bëhej më keq. Më këmbë nuk ngrihej dot më, megjithatë «mëkëmbësi i Allahut» mbi tokë vishej ëngjishej tamam si të ish në fron. Por sytë e mëdhej e të skuqur si zakonisht, tani kishin nisur të zbeheshin e të veniteshin. Ata kokërdhokë, nën vetullat e rënduara, vështronin me mosbesim e me inat... Urrejtje e pamatur dhe etje e përjetshme për gjak... Ata sý mund t'i gjallëronte vetëm gjaku... Po Sulltani tani nuk kish-te dhe aq gjak. Ninëzat e zvogëluara kishin marrë një ngjyrë jeshile. Vetullat e tij dikur korb të zeza e të dendura si hala bredhi, tani ishin thinjur e varur mbi qerpikët e rralluar. Në ballin e gjerë rrudhat ishin hapur tejpërtej dhe ishin shumuar. Tani ato lageshin dendur nga bula djerse. Dhe flokët e tij të shëndoshë e aq të shpeshtë dikur, në pak ditë ishin zbardhur krejt. Mustaqet i qenë varur poshtë dhe i binin mbi mjekrën e përndarë gjok-

sit. Të kuqtë e fytyrës ja kish lënë vendin një ngjyre të verdhë e pa jetë... pa shpirt...

Në të dy anët e shtratit i rrinin nga dy kopile, që i shërbenin paprerë. Ato i rregullonin shtratin, skufjen, jastëkët... I krihnin mjekrën e mustaqet. E kthenin në atë krah që urdhëronte ai dhe i rrinin gati për çdo gjë. Në tendë hyri Mehmeti. Sulltan Murati u ngrit pak mbi bërryl dhe ja nguli sytë të birit, që po rrinte i heshtur më këmbë.

— Si venë punët, Mehmet?

Ai bëri një hap përpara, u kollit pak, diç rregulloi në brez dhë tha: «Punët nuk venë keq, baba. Arnautët po mbahen me thonj e me dhëmbë. Por ne do t'ua thyejmë ata dhëmbë... do t'ua shkulim... Nuk do ta kenë të gjatë, baba. Muret e Krujës janë çarë në shumë vende. Topat do rrahin pareshtur deri në mesditë. Është e katërtta ditë që s'pushojnë. Kështu, si të janë sheshuar sa më shumë mure, do nisim prapë sulmin. Krujën do ta marrim me një frymë, baba. Besomë! Muret e saj janë çarë e bërë mazgall.»

Sulltani u mat të fliste por e mbyti gulçimi. Gjoksi i ulej e i ngrihej paprerë dhe sytë sikur iu futën më thellë.

— Nuk të zë besë, Mehmet. Dhe dëgjo, bir! Ki mendjen. Mos u përpinq të më gënjesht tjetër herë, se, për Allah, do të të mallkoj.

Mehmeti i ri dhe i rrëmbyer ra më gjunjë, në buzë të shtratit. I mori dorën të jatit dhe ja puthi me përulje. Por sa e çiku dorën tek buzët e tij, u rrënqeth. Vallë kjo qe dora e atit të tij? Kaq e ftohtë... Kaq pa fuqi?... Sa fort e mbante pallën dikur ajo dorë!.. Dhe sa me tërbim qëllonte atë-

here!.. Po tan? Ku vajtëna ata damarë, ai gjak i ndezur? Mehmetit të ri diç i theri në gjoks.

— Aq, adha Mehmet. Më mirë bjermë këtu Pasha Çakallozin.

— Pashai s'do t'ju thotë asgjë më tepër nga ç'dëgjuat, baba.

U desh punë që të gjëndeje Pasha Çakallozi, i cili drejtonte topat viganë që godisnin mbi Krujë. Pasha Çakallozi ish mbytur në djersë nga koka te këmbët. Ish lodhur së qëlluari me kamxhik topçinjtë, që vononin si për inat. Buzët i qenë bëre gjak të kuqe nga dhëmbët e vet. Ish e para herë që topat e Pasha Çakallozit bënин një vëré në ujë, dhe kjo e tërbonte pashanë.

Sapo mori vesh se e kërkonte Sulltani, ai rregulloi çallmën, veshjet, armët e brezit dhe u nis. Ish aq trupgjatë sa koka e tij lundronte mbi gjithë ushtrinë dhe dukej që përtetj. Ish një kokë që u kallte datën ushtarëve. Ai i njihte të gjithë. Ai dinte si kish luftuar secili. Atij nuk i fshiheshe dot. Kamxhiku i tij qëllonte aq keq, saqë farmaqet dhe vitet nuk i shlyenin dot ato plagë. Sytë i kish aq të mëdhenj sa dukej sikur të hante me shikimin e tij. Vetullat i përshkonin ballin tejpërtetj. Buzët e tij ishin shumë të trasha e gjak të kuqe.

Pasha Çakallozi vajti drejt e tek Sulltani. Në hyrjen e tendës u përkul përgjysmë dhe ashtu u fut brenda, duke viuar temenanë. Por edhe pas kësaj nuk ngrihej dot, se përndryshe koka e tij do të dilte mbi tendë.

— Çakalloz efendi, jam zaif — rënkoit Sulltani.

— Allahu juu bëftë të paktë, o mbret i mbretërve.

— Dëgjomë, pasha Çakalloz. Të kërkova vetëm pér një gjë. Dua të dëgjoj nga goja jote se qysh vënë punët. Zotrote e di që unë kam shumë besim tek ti. Pandehin të humburit se unë jam zaifur nga fati i luftës... Nuk është pér të qeshur kjo, efendi? Po, pa më thuaj, Pasha, cilën kala në botë sulmoi dhe nuk e mori Sulltan Murati, që të turpërohet sot përpara Krujës gjysmake? Folë, Çakalloz!

— Peqe, Madhëri! S'ka kala në botë që të mos meritojë flamurin e famës Suaj, o Sulltan mbi sulltanë. Po këtu punët s'i kemi dhe aq mbarë, Madhëri. Ky është një vend i nëmosur nga Allahu. Këtu nuk luftojmë si kudo, me robër të zotit, por me xhinde. Ndaj s'ua kemi marrë akoma dorën, Madhëri. Po ushtarët, shyqyr Zotit, i kemi të shumtë dhe trima. Barut e gjyle kemi sa të mbytim gjithë Arbërinë. Kështu, me vullnet të Allahut, edhe këtu do të valojë Hëna turke, Madhëri.

Sulltani ish ngritur pak mbi bërryl, por nuk qëndroi dot gjatë ashtu. Sytë e tij sapo kishin nisur të ndrisnin, kur aty pér aty u shuan prapë.

— Ti nuk flet keq, Çakalloz Pasha. Por ti, ama, flet atë që është. Ndaj të dua dhe ndaj të besoj, Pasha, Dëgjomë, Pasha. Merre Krujën! Merre dhe bën ç'të duash me të! Ja kështu! Po more Krujën, kërko nga unë ç'të të dojë zemra. Vetëm Krujën merre, Pasha! Krujën e dua. Merre Krujën, Pasha!... Zëri i Sulltanit sa vinte e humbiste. Ai kish nderë përpara dorën e hapur në drejtim të Krujës, sikur të priste që andej ndonjë lëmoshë. Ish

një dorë e tretur kockë e lëkurë që dridhej në ajër,  
duke shënuar Krujën.

Mehmeti doli nga tenda, duke shtrënguar  
dhëmbët me tërbim.

— Zëri juaj në vesh të Allahut, Madhëri.  
Krujën do ta sulmoj si bisha. Ose do ta marr ose  
do ta fshij nga faqja e dheut, Madhëri. Oh, do  
ta marr Krujën, Madhëri. Do ta marr se unë  
s'kam njojur prapsje asnjëherë, Madhëri.

— Ashtu de. Paç uratën, Çakalloz Pasha!  
Merre dhe bëje shkrumb. Dhe arnautët bëji  
shkrumb, Pasha. Bëji shkrumb që të mos kujtohen  
më për luftë... Që të mbajnë mënd mirë se si luf-  
ton Sulltan Murati... Merre... — Atë çast Sull-  
tanin e zuri kolla dhe nuk e mbaroi dot fjalën,  
Pasha Çakallozi bëri temenanë dhe u praps, deri  
sa kaptoi pragun e tendës. Pak më tej priste Meh-  
meti.

— Çuditem me zotërinë tënde, Pasha. Je më  
i zgjuari dhe më trimi i ushtrisë, po sa para bëjnë  
gjithë këto? Përse xhanëm nuk të erdhi një çik  
likshët për atë plak të drobitur? Nuk gjete dot të  
tjera fjalë për t'i ngrohur zemrën sadopak?

Çakalloz Pasha mbajti çapet dhe shikoi ashpër  
nga Mehmeti. Sytë e tij të egër sikur morën zjarr.

— Falëm, tepër i nderuari Zil-Ullah,<sup>1)</sup> por unë nuk  
di të gënjej, nuk mundem. Ja kështu është puna.

— ja ktheu ashpër Çakalloz Pasha, pa ja hequr sy-  
të.

— Ti je njeri pa shpirt, Pasha, po mos harro  
se një ditë unë do bëhem Sulltan, apo jo?

---

1) Zil-Ullah, kështu thirreshin atëhere trashëgimtarët e  
Sulltanit.

— Po pastaj? Ç'ke ndërmënd të thuash me këtë?  
— pyeti sërish me ashpërsi Pashai.

— Dua të them atë që do ta them kur ta dojë puna — ja priti Mehmeti.

— Kjo nuk më trëmb mua, Zil-Ullah. Unë kam luftuar aq shumë pér Derën Tuaj, saqë s'kam pse t'i trëmbem asnje lloj gjyqi. Ushtarët si unë kanë lindur të vrasin e të grabisin, por jo të gjykohen. Kurse zotrote lipset të jesh më i njerëzishëm, — i foli po me atë ton pashai, duke ecur bri tij.

— Mos don të thuash me këtë se im atë nuk më ka mësuar siç duhet? — pyeti tjetri me një ironi të hollë dhe të papërmbajtur.

— Babai yt është një nga ata burra që nuk i nënështrohen as gjykimit tim dhe as tuajit, ndaj është mirë ta mbyllim me kaq këtë muhabet.

Mehmeti nuk ja ktheu fjalën. Ata ecnin përmes çadraive të zbrazura e gjysëm të zbrazura të ushtrisë. Nga larg vinin gjëmimet lemeritëse të topave. Akoma më larg dalloheshin përmes tymit dhe flakëve muret e zez të Krujës, të nxirë nga tymbimi i barotit dhe nga zifti i shkrirë. Muret ngrihen radhë radhë njeri përmbi tjetrin të rëndë, plot madhështi, si harqe triumfi. Ata mure e tërbonin Mehetin e ri. Ata mure e hanin përbrënda gjoksit madhërinë e ri! Ato mure i shtypnin zemrën këtij djaloshi plot ambicje.

Pasha Çakallozi dhe Mehmeti u ndalën pranë topave. Ushtarët qenë bërë qull në djersë dhe qenë nxirë të gjithë si arabër. Dheu tundej e dridhej nga gjëmimet. Mehmeti ja vuri syrin një topçiu abisinas, trupmadh e i zhđervjellët, që ja kish përzhitur flokët e ballit flaka e barotit. Iu afrua, e



THE

— 95 —

mbërtheu pér supesh dhe, duke e shkundur me sa forcë që kish, e pyeti.

— A më thua, pérse qëndrojnë tē pamposhtur ata mure? Pérse nuk thyhen, pérse nuk rrashohen pér tokë? Pérse, pérse nuk pérmbiset ky vend i mallkuar?

Abisinasi, i habitur nē fillim, e mori veten shpejt. — Nuk e di, Madhëri. Këto janë gjëra që unë s'mund t'i di. Unë jam luftëtar dhe jo astrolog, Madhëri. Por mëndja ime më thotë se ato mure janë tē shënja dhe se janë bekuar nga dora e Zotit, Madhëri. Ndryshe s'ka se si tē jetë. Kemi zbrazur mbi ta aq shumë zjarr dhe llavë sa s'bëhet hesap. Tjetër nuk di ç'të them, pér Allah, nuk di.

Sakaq Mehmeti e mbërtheu pér shpatullash dhe e pérplasi pér tokë. Abisinasi rënkoj thellë. Nga buzët i vërshoi një curril gjaku.

— Dëgjoni ju, edepsëzë dhe maskarenj. Në botë vetëm një vend ka bekuar Allahu. Morët vesh? Ta mësoni mirë këtë pastaj tē luftoni.

Çakalloz Pasha, që e kish parë nga afér këtë skenë, iu afrua Mehmetit, i rrahu supin me atë pëllëmbën e tij tē madhe dhe i tha:

— Bëjmë më tej, Zil-Ullah.

Të dy burrat u nisën serbes pér aty ku derdheshin gjylet. Këtu njerëzit punonin lakuriq nga mezi e lart. Zjarret dhe flakët tē mbysnin nē djer-së. Shkrirësit punonin nē një varg tē gjatë që s'i dukej fundi. Pas tyre vinin derdhësit nē dy vargje, po aq tē gjatë sa dhe i pari. Më nē fund vinte një sërë me kovaçë tē zgjedhur, që lëmonin e përsos-nin gjylet e derdhura. Mehmeti iu afrua një derdhësi armen që tregohej tepér i zellshëm. Por ar-

meni i gjorë u hutua nga prania e papritur e Princit, duart iu drodhën dhe gjylja e derdhur i doli aq e shtrembër sa të merrte gazi tek e shikoje.

Por Mehmetin nuk e mori gazi. Ai i dha një grusht turinjve armenit dhe i shfryu aty për aty.

— Me këto gjyle do t'i thyeni ju muret e Krujës, o shogola. Çfarë bëni kështu? Mos pandehni se derdhim gjyle për të qëlluar sorra? A merrni vesh se na duhen gjyle që të thyejnë hekurin dhe të shpojnë muret e gurta arnaute tej për tej?

Kaq tha Mehmeti dhe u largua si një re e mbushur me shi. Të tjerët morën frysë të lehtësuar, duke u kthyer gjithsecili mbi punën e tij.

Pasha Çakallozi nxiti çapin dhe e arriti Mehmetin.

— Je tepër i ashpër, Zil-Ullah. Allahu të faltë, po je tepër i ashpër. Kjo ashpërsi lipset kur ushtria rri, po jo kur lufton, jo në shesh të mejdanit.

Mehmeti mbajti çapat dhe iu kthye: — Me edepsëzët kështu lipset të jesh, Pasha.

— Këta nuk janë edepsëzë, po ushtarë. Mos harro se babai yt i nderuar, mëkëmbësi i Allahut mbi tokë, nuk mban maskarenj në ushtrinë e tij, — ja ktheu Çakalloz Pasha.

— Jo, Pasha. Edhe zotrote e di, se maskarenj janë, por këto i thua që të më fyesh.

— Gabohe, Zil-Ullah. Për Allah, gabohe. Ata mund të janë hajvanë, budallenj, bile edhe maskarenj mund të janë, por në luftë nuk duhen përbuzur, se pa ta s'e bëjmë dot luftën. Këto janë ligjet e pashkruara të luftës.

Mehmetit i shkrepën sytë nga inati. Ai ngriti

lart dorën e tij gjithë muskuj, por e uli prapë ashtu' dalngadalë, pa ja hequr sytë tjetrit.

— Pasha, të faltë Allahu! Po Allahu është shahit se sot më ke rënë më qafë. Mos e harro këtë. — Kaq tha Mehmeti, i ktheu krahët dhe u largua me nxitim.

Çakalloz Pasha u kthyte tek ushtarët. Ata qenë kapitur. Pashai i ndërroi menjëherë topçinjtë dhe urdhëroi një zjarr të dyfishtë mbi qytet. Afroi mesdita. Muret qenë çarë e vazhdonin të çaheshin në shumë vende dhe jepnin shpresa të mëdha se garnizoni arbëror do t'i lëshonte armët. Pasha Çakallozi dha shenjën e sulmit. Turqit u lëshuan përpara me ulërima e sokëllima aq të mëdha, sa të dukej se dhe qelli do t'i zinte veshët. Bartnin me vete shkallë, qysqi, lloze hekuri, topuzë e gjithfarë armësh për të goditur mbi garnizonin e paepur. Por tek muret e kalasë i priste një zjarr xhenemi, që të verbonte sytë e të merrte mentë. Si u prapsën ca, turqit u lëshuan përpara me furi dhe u varën mbi muret. Kudo nga pas i nxiste zëri i Çakalloz Pashës. Ai u jepte zemër e fuqi të gjithëve. «Ç'është kështu kapedanë dhe trima? A nuk jeni ju që s'kini lënë mure në botë pa ngulur flamurin tonë fitimtar? Ju që kini përgjunjur gjithë ato ushtri e vende, të prapseni përpara një grushti arnautësh të egër e barbarë! Mos vallë në dejt tuaj nuk rreh më gjaku i zjarrtë i fitimtarëve? A mund të besohen këto? Shtrëngoni jataganët dhe përmbyssini këta mure të mallkuar! Atdheu dhe Sulltani nuk do t'jua harrojnë trimërinë dhe guxmin që po tregoni sot». Pas këtyre fjalëve ushtarët u vërsulën me tërbim mbi muret e paepura.

U vinte t'i hanin me dhëmbë këta gurë të ashpër. Pasha Çakallozi renditi harkëtarët e zgjedhur, për të goditur mbrojtësit e bedenave. Harkëtarët nisën të qëllojnë me furi dhe pa marrë frymë. Tuva shigjetash çanin me vërvshëllimë ajrin dhe binin mbi bedenat e gurta. Nga të katër anët aviteshin dhe mbëshfeteshin mbi mure shkalla gjithfare, të cilat sakaq mbusheshin me turçelinj. Porta kryesore e kalasë goditej me një direk të hekurt që punohej nga 200 ushtarë të zgjedhur. Pasha Çakallozi po e drejtonte vetë vendosjen e një shkalle vigane mbi muret e kalasë. Asnjë shkallë si ajo nuk ishte parë ndonjëherë në ushtrinë turke. Pas pak bedenat u zbrazen nga mbrojtësit. Kjo u dha zemër dhe kurajë sulmonjësve. Dukej sikur këtë radhë Kruja do binte në duart e ngadhnjimtarëve. Ushtarët e parë kishin hipur tanë sipër mureve. Nga shkallët vigane filluan të vërshojnë mbi mure mizëri ushfarësh. Sipër zotërit e kështjellës nuk po ndiheshin më. Kjo i shpejtonte sulmonjësit të ngadhënonin. Në krye të shkallës një turk, zdap i gjatë e mavri i zi, po mbante në dhëmbë flamurin perandorak, për ta ngulur fitimtar në muret e Krujës. Gjatamanit po i avitej një sirian i shkurtër e i mbushur. Siriani e kapi për këmbe turkun dhe e têrhoqi poshtë. I rrëmbeu nga goja e gjakosur flamurin e i dha të shtymen në humnerë. Paskëtaj vijoi të ngjitej vetë i sigurt se e fitoi më në fund kurorën e murit.<sup>1)</sup>

---

1) Kurora e murit — i jepej atij që ngrinte flamurin i pari në muret e kalasë armike.



Sulmi vazhdonte me furi gjatë gjithë mureve të gurta. Porta kryesore kish nisur të lëkun-dej. Pasha Çakallozi rendte mbi kalë sa në një krah në tjetrin, i larë në djersë. Ai diku nxiste, më tej mburrte, disa i shante, të tjerë i ndëshkonte. Sulmi po shkonte aq mbarë, sa nuk kish shkuar ndonjëherë... Fati, fati tekanjoz sikur po i buzëqeshë Pashait... «Me të vërtetë do ta mposht pra, më në fund këtë vend të xhindosur?... Ashtu de... Jo më kot më thonë Çakalloz Pasha!... Jo më kot Sulltani më ka përmbi të tjerët... Jo më kot i biri më urren përmbi të tjerët, qe e maroftë shejt-tani e vaftë. Fati po më buzëqesh... si gjithmonë... Por ki mendjen, Pasha! Mos u deh para se të pish!.. Po kjo ç'është? Bedenat e kalasë së lane-tisur u mbushën plot me arbër, që dreqi e di se nga dolën kaq shpejt dhe kaq papritur.»

Flamurtari sirian duke u përmbysur në humnerë ulërithi. «Xhindët, xhindët, prapsuni!»

Nga sipër qëllonin si të tèrbuar me gjyle, me shigjeta, me gurë, drurë e me gjithfarë sendesh xhehenemi. Derdhej si lumë zifti i shkrirë, uji i valuar e gjithfarë lëngjesh të nxehtha. Shkallët po përmbysheshin njëra pas tjetrës. Flamurët e kapur nga mbrojtësit po griseshin në sytë e ushtarëve. Çakalloz Pasha u derdh si gjëmë nga shkalla vigate pér të hipur vetë në krye. Por ish vonuar! Edhe këtu të «pabismilahët» e kishin bërë të tyren. Shkalla mori zjarr nga sipër. Ushtarët turq të tmeruar e të lemerisur po prapseshin duke shtypur njëri tjetrit e duke përhapur panik.

Pashai mbeti si i ngurosur mbi kalë. Në atë rendje të çmendur i kish rënë diku çallma dhe flokët e tij gjysëm të thinjur po i pérndante era andej këtej, siç po pérndante ushtrinë goditja e mbrojtësve. Mjekra i dridhej mbi gjoksin e gjerë e të veshur në çelik. Sytë po i futeshin thellë e më thellë, ndërsa vetullat e ngrysura po i vareshin pérpara, sikur donin të mbulonin atë pamje të hidhur të dritës së syrit... «Eh fat, o fat i pabesë... Mos vallë umplaka unë, pasha Çakallozi dhe nuk ja dal dot më? Mos vallë umplak gjithë kjo ushtri e madhe? Mos vallë umplak dhe mbretëria jonë e lashtë. Apo këtë vend të xhindosur e mbron vetë Allahu? Po ç'punë ka Allahu këtu, me këta të pabesë?... Muhameti nuk na thotë asgjë pér këto mure të nëmosura. Përse pra të mos e shtiem në dorë? Eh fat, o fat i zi. Përse ma ngjeshe me të pabesë këtë kamxhik të ashpër?... Ç'do t'i them Sulltanit të varfër. E cila zemër do t'i durojë rën-

kimet e të sëmurit? Mos vallë të gjithë jemi molep-sur nga sëmundja që të na tallin kështu një grusht arnautësh? Leri këto mendime, o ushtar, po bëj përpara e merr komandën!».

Pasha Çakallozi po tërhiqte ushtrinë që të pre-gatiste sulmin tjetër vendimtar. Dielli s'qe varur ende nga perëndimi, pra koha mjaftonte dhe për-këtë sulm, po qe se do të vinte mbarë. Nga ana tjetër dha urdhër që topat të fillonin kërdinë mbi muret, pa pushuar asnje çast. Turqit nisën të têr-hiqeshin, duke mbledhur kufomat dhe pajimet. Papritur u hap porta e kështjellës dhe ushtarët ar-bërorë sulmuani me një furi stuhie. Pasha Çakallo-zi me kohortën e tij, u ndodh në ballin e goditjes. Shpatat qëllonin me têrbim dhe vringëllinin me oshëtimë. Pashai ndjeu diçka të ngrohtë në faqe. Vuri dorën aty. Gjak! Ish plagosur në tembla. Sa-kaq mbrojtësit u têrhoqën më shpejtësi, duke marrë me vete kokat e prera të armiqve, flamurët dhe pajimet e tyre luftarake.

Nga kryeqendra, arriti duke rendur mbi kalë Mehmeti. Ai, i ngrysur prej natyre, u nemit edhe më keq nga pamja e ushtrisë së thyer. Qëndroi kalin dhe hëdhi vështrimin përreth. Sytë iu futën edhe më thellë në zgavra dhe bebëzat iu zvogë-luan aq sa mezi dukeshin. Ngriti kamzhikun lart. sikur dikë do qëllonte. Po dora i mbeti ashtu e ngritur dhe kamzhiku i varur iu mbështet mbi supin e mëngjér... Ushtria têrhiqte mbeturinat dhe dëmet. Shkallë të përmbyrsura e të djegura, kufoma të gjymtuara, kurme, kocka e kafka të cara, heshta të thyera, shpata pa zot, ushtarë pa këmbë apo pa duar, flamurë gjysëm të djegur — ja me se i kishin

gostitur arnautët e egër që përtej mureve. Mehmeti e humbi mendjen përpara asaj pamjeje të tri-shtuar për të. Mendohej si e qysh t'i fundoste një herë e mirë ato mure të gurta. T'i fundoste diku thellë në fund të dheut, që të mos i dilnin më përpara syve. Mendohej Mehmeti i ri si e qysh t'i fshinte nga faqja e dheut këto mure të çelikta, që i marrtë dreqi i marrtë. Përse të mos qe shpikur akoma një lloj zjarri për të djegur këta gurë, siç digjet baruti? Edhe sikur këto mure të ngriheshin deri në qiell, prap se rapë do kishin rënë nga gjithë kjo kërdi e paparë... Ç'dreq mure janë pra këto? Ç'duhet përdorur tjetër gjë përveç zjarrit dhe hekurit? Ç'forcë i mposht këta të pabesë?... Në këto e sipër përpara Mehmetit u gjend Çakalloz Pasha, i gjakosur në duar e në fytyrë.

— Ç'është kështu, Pasha? shkulët gjithë vendin dhe shurdhuat gjithë miletin me ata topa. Ku venë vallë gjithë ato gjyle? Qëlloni mbi kështjellë, apo mbi laraska?

— Mbi kështjellë, Zil-Ulla, se laraska nuk ka në këtë vend të nëmosur. Vetëm korbat enden ditë e natë mbi kokat tona.

— Ç'do të thuash me këto fjalë, Pasha — pyeti tërë inat Mehmeti, duke e shikuar drejt e në sy.

— Dua të them se për ushtarët trima s'duhën zënë në gojë laraskat. Jemi në luftë dhe lipset të flasim si në luftë, ashtu siç dinë të flasin ushtarët.

Mehmeti i shkrepëtiu sytë. — Unë flas siç dinë të flasin kapedanët dhe jo si ushtarët, Pasha. I jeni zotuar Madhërisë t'i dorëzoni kyçet e Krujës. Ku janë kyçet? Shkulët gjithë tokën me bataretë e topave dhe, ç'keni bërë? E ç'hyjnë fjalët e ushtarëve në këtë mes? Këtu ka fjalë burrash. Ku janë

çelësat e Krujës? Juve aga, ju vjen më mbarë të gjeni sebep sherri me mua, se sa të kurorëzoni sulmet e ushtrisë.

— Zotrote gabohe rëndë, Zil-Ullah. S'kam patur asnijëherë qëllim të zihem me dikë. Jeta ime njeh vetëm një qëllim. Të vras dhe të çfaros nga faqja e dheut sojin e të pabesëve. Të djeg e të pjek në hell të gjithë rebelët, që guxojnë të ngrenë krye përmbi Sulltanin tonë. Të grabit, dhe të shkrettoj gjith këtë farë zbatharakësh, të cilëve u thotë mendja se mund t'ja dalin edhe pa kujdesin e Madhërisë. Ndërsa zotrote, Zil-Ullah, do të bëje më mirë të mos ndizje pa arësyte sedrën e ushtarrëve të tillë, siç jam unë. Pastaj, mos harro Zil-Ullah se harkëtarët dhe agreptarët<sup>1)</sup> që drejtovë zotrote qëllonin aq kuturu, saqë dendur godisnin pararojën time. Dhe jeniçerët tuaj pak e mbësh-tetën sulmin tim nga porta kryesore. Për këto, sonte në aksham do flas vetë me Madhërinë.

Mehmeti u rrënqeth mbi kalë. E shikonte drejt në sy Pashanë, pa ditur se nga t'ja mbante.

— I ndjeri Jusuf, dhaskali im i fëmijërisë, më ka lë, amanet se inati duhet vënë ndën politikën, përndryshe ndarja jonë sot nuk do ish buzagaze. Kaq sa për marrëdhëniet tona. Tani për detyrën. Madhëria urdhëron të pritet sulmi për sot dhe të çlodhet ushtria. Në aksham Madhëria ju pret në tendifën e tij. — Kaq tha Mehmeti, ktheu kalin dhe humbi në revar, përmes mizërisë së çadrave.

Çakallos Pasha është pa vonim urdhërat e fun-

---

1) Lloj arme në ushtrinë turke.

dit, la kalin dhe u nis më këmbë për në tendën e tij... Udha i ra përpara tendës së Hysen Pashës. Aty mbajti pak çapet dhe mendohej, të kthehej apo jo. Kish kohë pa e parë Hysenin. Ç'bënte mbajtësi i fermanit, qe trashur edhe më? Vijonte si gjithnjë të derdhej aty vera? Çakalloz Pasha s'e bëri të gjatë, po preu në të mëngjër dhe hyri brenda. Ai nuk mbante stoli të shtronjtë e të shkëlqyera. Ai thoshte dendur këto fjalë. «Insani duhet të lakmojë derisa është krijuar për të kënaqur oreksin dhe lapërdhinë».

Në tendën e Hysen Pashës mungonin shinashi-nët dhe saltanetet e tjera të një pashallëku. Ai vetë kënaqeji më tepër duke ndenjur këmbëkryq mbi çiltera të trasha, mbushur me dupla shpendësh. Pasha Çakallozi e gjeti atë ashtu siç gjendej rëndom. Përpara ish shtruar një tepsi plot mish dashi, të pjekur me një zotësi të rrallë. Në të djathë mbante ibrikun e verdhë me verë të kuqe. Bile, pashai, as gota vere nuk mbante në tendën e tij. Ai thoshte se vera shijohet më mirë me ibrik se sa me qelqurina.

— Me sa vërej unë, efendi, zotrote fare pak kujdese për trupin — i tha Pasha Hyseni mysafirit të tij. — Xhani është xhan dhe trupi është trup. Ato vërtet ndahen pas vdekjes, por ama, sa jemi gjallë s'bën t'i ndajmë, meqënëse këtë gjë s'na e këshillon profeti.

— Gjithkush e merr vesh profetin pas radares së tij — gjegji tjetri.

— S'e kam aty llafin, Pasha — vazhdoi Hyseni duke fshirë buzët e trasha e gjak të kuqe. — Zotrote je një kollonë ku mbahet së paku gjysma

e perandorisë. Por zotrote vetveten nuk e shikon fare, sikur ajo t'i përkiste një tjetri. — Hysen Pasha fliste mjaft ngadalë. Përtypet akoma më ngadalë, ndërsa ibrikun e zbrazte si i etur. Sikur Pashai të mos e kishte barkun aq të madh, mijekra e tij, tek rrinte ashtu këmbëkryq, do çikte mbi gjunjët. Pak ishin zbardhur leshrat e pashait krahas moshës së tij të shkuar. Sytë megjithëse të mëdhej, pak dukeshin, të rrethuar ashtu nga queskat e varura rrrotull, plot mish e dhjamë. Ata sy ngjanin si dy gjuhë të holla qiriri, gjë që dëshmonte se pashai ish i zgjuar jo më pak nga ç'ish i majmur.

— Unë s'them se njeriu nuk duhet të bëjë çmos në jetë, por ama këtu ka një kufi natyral. Jas si është ky kufi. Do përpinqem të ta shkoqit. Njeriu duhet t'i japë fund karierës, jo kur sakatohet apomplaket, por më përpara. Kur ai arrin të bëjë një vepër fort të ndritur, për të cilën mendon se nuk do të arrijë ta përsëritë më në jetë, apo të bëjë diçka më të madhe, aty duhet t'i thotë vetes stop. Aty mbaron vepra, dhe aty fillonjeta. Aty njeriu duhet të shikojë trupin dhe jo më shpirtin. Ndërsa në kujtimet e tij duhet shkruar fjala e artë «fund».

— S'jam në këtë mendje edhe sikur të mbaresh në lule të ballit, efendi — e kundërshtoi aty për aty mysafiri kokëfortë.

— Zotrote s'je i shtrënguar të marrësh mend e mia, por s'bën keq po të m'i dëgjosh dhe këto llafe. Zotrote ke pse të mburresh me bëmat e tua të ndritura në jetë. Po më duket se kësaj radhe s'do ja dalësh dot në kut. Kjo Kruja është kockë që s'përtypet. Në qoftëse e merr, dije se s'do ketë

rast më të lumtur e më të artë se sa ky, për t'i dhënë fund veprës sate të madhe. Por ama po dështove, pak do të mbetet nga emri yt i madh.

— Ushtari duhet të mbetet ushtar gjë ditën e fundit, Pasha. S'ka ligj tjeter për ushtarët, përveç vrasjes dhe grabitjes. Keqardhjen ua kemi lënë grave dhe perëndive. Raca njerëzore ka lindur të vrasë dhe të vritet.

Pasha Hyseni hante me një shpejtësi mahnitëse. Çakalloz Pasha u çudit se si tjetri çveshi aq shpejt kokën e pjekur të dashit, sikur ajo të mos qe mbushur me mish, po me lakra. Pas kokës, pashai mori njerën nga shpatullat e dashit. Qe merakli i madh për shpatullat. U xhvaste mishin gjersa kocka pastrohej si pasqyrë pastaj këndonte aty të thënën. Kështu veproi dhe këtë herë. Papritur pashait iu prish çehrja e tij baballëke. Ai e vërtiti disa herë kockën e shpatullës sa me një anë në tjetrën, pastaj e flaku si të ish thëngjill i ndezur.

— Ç'pate ashtu, pasha, — pyeti Çakallozi si më gjemba.

— Mynxyrë, mynxyrë, efendi. — Gjegji Hyjni. — Mynxyrë e parrëfyer. Kemi një tabut në mes të ushtrisë. Merr vesh, apo jo! Një tabut të madh.

— Kot sa trondite kështu, Pasha, — u përpoq ta qetonte mysafiri. — Ai tabut mund të jetë dhe imi. Kanë vdekur aq shumë, sa s'ka kush të vdesë më.

— Jo, jo! Mua s'më gënjen ameli, efendi. Është tabut i madh ai. Është tabuti më i madh që kam parë deri më sot ndër shpatulla. Jo, nuk gjënjehem, efendi. Kjo profeci s'i kushtoi gjë Hysenit,

mbasi aty çdo ditë vritheshin disa nga të mëdhejtë e ushtrisë.

Afrohej koha e kuvendit në tendën e Madhërisë, ndaj të dy pashallarët e prishën gostinë.

Në pak kohë tenda e Sulltanit u mbush cep më cep. Pashallarët dhe gjeneralët qenë renditur përpara shtratit të Madhërisë në formë gjysëmrrethi. Asnjëherë s'qenë dukur në atë tendë aq shumë mjekra dhe mustaqe gjithfarësh! Vetëm Mehmeti qëndronte pranë të jatit. Sulltani qe hequr, aq sa mezi njihej! Ai ngjante me një të botës tjetër. Lëkura i qe ngjitur për kockash dhe i qe zbardhur aq shumë sa pandehje se kockat kishin dalë sheshit. Mezi qe zgjuar para dy orësh. Në gjumë kish èndëruar pallatin e tij madhështor në Magnisia, në Azinë e Vogël.

Kryheqimi, Murtai, tani nuk i ndahej asnjë minutë nga krei i shtratit. Farmaqet ja gatuante dhe ja konte me dorën e tij. Edhe vetë Murati ish dobësuar e ish tretur nga shërbimi i pandërrerë.

— Përse më rrini duarkryq, efendilerë? Me sa di unë, asnjërit nga ju nuk i ka vdekur gruaja. Dua të di ku është Kruja. Dua të di ku e kini bukëshkalin Skënder, të lidhur e të bërë zap. Përse nuk ma muartë Krujën? Çfarë ju mungoi vallë? Fol zotrote, Çakalloz Pasha, çfarë ju mungoi?

— Mua më duket se përveç vullnetit të Allahut, asgjë nuk na mungoi, Madhëri — qe përgjigja e Pashait.

— Allahu është i madh dhe Muhameti është profeti i tij — tha ngadalë Sulltani. Në tendë ra heshtje. Askush nuk donte të fliste në atë vend. Shtrati i Madhërisë dukej aty si një plagë e hapur,

e rëndë, që të merrte frymën dhe gojën. Pashallarët s'e ndjenin mirë veten aty. Ata nuk i mbante dot ky vend i mbushur me stoli. Nuk shikonin dot as Sulltanin, as Zil-Ullahun dhe as njeri tjetrin. Të gjithë ja kishin ngulur sytë Murtait, sikur të kishin ardhur këtu vetëm për atë. Ata donin të prapseshin nga ky vend, donin të fshihnin hë për hë barqet e fryra e të majmura përtej masës.

— Flisni, efendilerë, kur do më dorëzoni kyçet e Krujës? A më dëgjoni? Dua Krujën! Nëmni Krujën, pa derman dhe merrni nga unë ç'të doni. E dua Krujën. Ju urdhëroj prerazi se Krujën duhet ta merrni deri nesër në aksham. Kush e merr përsipër këtë?

Kjo pyetje i rrënqethi të pranishmit. E kush mund ta merrte Krujën? Të ish për të marrë, do të që marrë me kohë! Kruja! Ajo ato ditë ish mbuluar nga retë dhe mjegullat e tymit të zjarreve. Nga kjo, mjaft turq pandehnin se aty ndodhej froni i të madhit Zot. Ndryshe s'kish si të mbahej ky vend vetëm nga një grusht burrash. Vetëm se turqit harronin që këta burra ishin arbër dhe luftonin nën udhëheqjen e Skënderbeut.

— Përse ju është lidhur gjuha, efendilerë? Ku janë oratorët midis jush? Ku janë burrat, ku janë ata kapedanët e vërtetë? Kruja juva paska marrë të gjitha, edhe gojën, edhe veshët, edhe sedrën. Epo flisni de, përse nuk flisni? Sulltani juaj ju urdhëron të merrni Krujën deri nesër në aksham, përndryshe...

Cakalloz Pasha bëri dy çape përpara. — Me vullnet të Zotit, nesër në këtë vakt do të jini duke kremtuar brenda mureve të Krujës.

— Paç uratën, Pasha! Tërë jetën mos t'u ndaf-të mbarësia! Mos t'u ndafshin dora dhe syri i Zottit! Vetëm kij mendjen, pasha. Burri pér fjalësh si demi pér brirësh. Thika gjithnjë ka dy presa.

— E di, Madhëri. Dhe presa e dytë do heqë koken time, po qe se Kruja nuk do të mposhtet — u zotua Pasha Çakallozi.

Tenda u zbras më shpejt nga ç'pritej. Jashtë çdo gjë u ndez nga rrëmuja. Po aty Mehmeti bënte çmos që asgjë të mos merrej vesh brenda tendës. Në kohën kur bëhej mbledhja me Sulltanin, në lindje të kampit qe bërë nami. Skënderbeu e kish shkuar në thikë e në flakë atë çip të kampit. Ai kish rënë papritur si një zjarr mbi stivat e thata të druve, duke përmbysur e shkrumbuar çdo gjë. Zhdukja e kalorisë së tij nga kampi ish po aq mahnitëse sa dhe ardhja. Kjo i tmeroi e i shastisi turqit. Shumica mendonin se me Skënderbeun do qenë bashkuar forcat aleate, ndryshe s'kish nga vërshonin gjithë ato sulme e batërdira. Të tjerë, përkundër, mendonin se në ato sulme kish diçka të pa-kuptuar, mistike, diçka përbimi forcat e një grushti arnautësh.

Sulmi i Skënderbeut bëri të dridhej i gjithë kampi i paanë i Sulltan Muratit. As masat fort të rrepta të Mehmetit, as kujdesjet e tepruara të të tjerëve s'mundën t'ja fshihnin Tirani këtë ngjarje. Madhëria qortonte të birin — Qysh kuturis të më fshehiësh këto gjëra, mor bir! Po pse, q'më pandeh mua ti? A nuk jam më unë Sulltan Murati? Po, mor bir, ja kështu është. Kruja nesër do bjerë. Sapo e tha Çakallozi me gojën e tij, kjo punë ka marrë fund. Ti nuk e njeh Çakallozin, mor bir!



Ai s'më ka gënjer asnjëherë. Ai do ta marrë Krujën... S'mirrej vesh, në Murati fliste me vetveten, apo me Mehmetin e humbur në mendime. Atij s'i dukej se po fliste po sikur këndonte, këndonte pa pushim hymnin e fitores...

Murtai dremiste aty tek koka e tiranit. Ndjeu në sup një dorë që po e shkundte lehtë. Hapi sytë.

Para tij qëndronte Mehmeti. Kryeheqimi brofi në këmbë.

— Eja pak me mua, Murtaj efendi, — i tha atij Mehmeti, duke dalë vetë i pari nga tenda. Sapo kapërcyen pragun, Mehmeti i tha. — Shko të çlodhesh, Murtaj efendi! Nuk shikon se si je katanësur? Qysh do shërosh një tjetër kur vetë po bëhe pér ditë më keq? Sjellja jote është tepër fisionike, por sidoqoftë, kjo e zemëron Allahun. Zoti na e ndalon ta keqpërdorim vetveten, efendi.

— Fjalët e tua janë shpërblimi më i madh që kam kërkuar, Zil-Ullah. Me lumtëri të patreguar do ta bëja kurban jetën time, sikur Madhëria të mirësohej sadopak. Ndaj nuk ja vë veshin vetes.

— E ke gabim, Murtaj efendi. Kush do vijoje kujdesjet e tua, nëqoftëse zotrote nuk do jesh në gjendje? Prandaj, nisu në çadrën tënde dhe çlodhu një copë herë. Mos kij asnje merak, se pér çdo rast do të flas pa vonim.

— Falmëni, Zil-Ullah, po unë përgjigjem me kokë pér Madhërinë — kundërshtoi heqimi.

— Po ti nuk ke se si përgjigje me kokë, po qe se koka jote është e turbullt, efendi.

Heqimi s'nguli më këmbë, po u nis me çape të plogëta. Ai jo më kot s'donte të ndahej nga i sëmuri. Heqimët dinë shumë pér fatin e Sultani. Eh, sa shumë dinë heqimët! Nuk bën që trashëgimtari ambicioz të ruajë Atin e sëmurë rëndë. Allahu na ruajtë! Kjo nuk lejohet. Kështu kryeheqimi, para se të mbërrinte në çadrën e tij, urdhëroi heqim Selimin të kalonte natën pranë të sëmurit. Të mos largohej pér asnje çast, edhe sikur Mehmeti t'i priste kryet. Selimi u nis me të shpejtë. Vetëm pas kësaj kryeheqimi u nis i qetë në çadrën

e tij, dhe ra për të fjetur ashtu siç qe i veshur. Në tendën e tiranit hynë 'njëri pas tjetrit, heqim Selimi dhe astrologu i madh i Divanit, Karahman efendiu. Bënë temenanë e zgjatur para Mehmetit të vrenjtur dhe u drejtuanc sërisht tepër ngadalë. Mehmeti dhe Karahman efendiu u hoqën mënjanë në pjesën tjeter të tendës, ku u ulën mbi dy shaneshinë të lartë e të stolisur gjithë shkëlqim.

— Ç'thonë shkronjat e qiellit, efendi? — pyeti Mehmeti, duke liruar brezin që s'e kish hequr ditë e netë me radhë. Karahman efendiu kruajti kokën që s'i hante, rregulloi çallmën dhe, duke drejtarar mjekrën, u përgjigj:

— Zor të kuptosh lëvizjet e yjeve të këtyre netëve, Zil-Ullah. Asnjëherë në jetë s'kam parë yje më të çoroditura e më të daldisura. Më duket se yjet janë pirë e s'dinë se ç'bëjnë. Ata po lëvizin kundër gjithë ligjeve të astrologjisë. Këto gjëra unë s'i këndojet dot me saktësi por sidoqoftë ato nuk dëshmojnë për ndonjë të pritme të mirë.

— Ju duhet t'i këndoni me saktësi të thënat e yjeve, Karahman efendi. Për këtë punë kini mësuar dhe me këtë punë jini marrë gjithë jetën. Kush tjetër veç jush do ta bëjë këtë punë? Mos vallë do na ndihmojë këtu më i sipërm i arnautëve — Skënderbeu?

— Unë s'desha të them këtë, Zil-Ullah. Po di se ka raste që insani i Allahut, sado i kënduar që të jetë, nuk arrin të kuptojë as veten e tij dhe jo më shenjat e yjeve të largëta. Jemi robër të Zotit dhe ai lot me ne si t'i tekët.

— Ç'don të thuash me këto fjalë?, — pyeti i rrëmbyer Mehmeti, duke u vaisur përpëra mbi astrologun plak.

— S'ka gjë për të prishur gjakun, Zil-Ullah! Thashë se këndimi i yjeve nuk shpreh për ndonjë të pritme të mirë. Ndaj duhet pritur çdo myn-xyrë që gatit Zoti si provë apo si ndëshkim. Në këtë vend të nëmosur duhet pritur çdo gjë. Aronautët nuk janë nga ajo fara që Zoti krijoj prej ballës, këta janë pjellë xhehenemi, Zil-Ullah. — Kaq tha astrologu plak dhe kërkoi leje të shkojë, për të parë se mos kushedi nga qielli shkruhej ndonjë gjë ugurbardhë. Mehmeti mbeti vetëm... «Hëm... mos më duhet të kurorëzohem këtu... përpëra nië armiku të pamposhtur dhe me tim Atë, pa frymë. Dhe kjo do jetë një shenjë ugurmirë për fatin tim? Ah, jo! Allah i madh të qofshim falë, mos e bën këtë. Jo në këto rrëthana. S'ka se si të më vejë mbarë një trashëgim i këtillë...

Sulltanit i shkonin djersë të ftohta ballit. Ai kthehej sa më njerin krah në tjetrit, pa mundur të rehatohej. Sytë i mbante gjysëm të çelur. Më në fund nisi të flasë përcart.

«... Ashtu de... e morëm Krujën, më në fund... po përse, c'janë gjithë ata flamurë të arnautëve? Mehmet, ku je mor bir... përse më kanë rrëthuar nga cdo anë arnautët? Hiqmini qafe këta belaxhinj... Po Skënderbeu c'aenka rritur kaq shumë, mor bir?.. Përse s'e kini lidhur Skënderbeun? Çakalloz, folë mor bir, përse s'e kini lidhur bukëshkalin? Sill-mëni pallën, t'i heq kokën. Po përse xhanëm është rritur kaq shumë? Qysh e ka hedhur gjithë këtë trup?.. Pa vështro, Mehmet!.. Koka e tij arrin përmbi gjysmëhenën ... Po ku janë kyçet e Krujës, Çakalloz... Ti më kishe dhënë fjalën... Dhe përse xhanëm nuk i lidhni kapedanët e arnautë-

ve?.. Përse nuk e lidhni Skënderbeun. Ai do na bëjë ndonjë hata... Të lumtë, Çakalloz, se e mbajte fjalën!.. Po ku është flamuri ynë xhanëm? Përse s'e ngrini mbi kala?..»

Heqim Selimi me një elbaze mëndafshi i fshinte djersën e ballit.

Mehmetit s'iua durua më. Dolli jashtë dhe thirri gjithë heqimët në tendën e tij. Ata erdhën duke rendur, njeri më mahmur nga tjetri!

— Dëgjomëni mirë ju, që aq bukur i njihni të fshehtat e jetës dhe të trupit, — nisi të flasë Mehmeti. — Siç e shikoni, Madhëria nuk është mirë. — Allahu mos e dhëntë po e thëna mund të ngjasë dhe në këto rrëthana. Ju fal çdo gjë në jetë, agallarë, vetëm për tim atë nuk ju fal dot. Ndaj bëni çmos ta shpëtoni. Kudo le të vijë e thëna, vetëm këtu jo. Jo! ju them! Jo, përpara mureve të këtij xhehenemi arnaut! Jo përpara Skënderbeut kryeneç e fitimtar. Bukëshkali i shtypi e i përtypi kockat e tim eti. Unë do ja nxjerr nga hundët kur të vijë dita, por sot agallarë, im atë dhe perandori juaj, duhet të shpëtojë medoemos, me çdo çmim, me çdo mënyrë. Folni, ç'doni nga unë dhe c'mund të bëj unë për të shpëtuar Madhërinë? —

Heqimët ulën kokat, e mbuluara me thinja. Mehmeti përpiquej t'i vështronët në sy, drejt e në driten e syrit, por ata shikonin dyshemenë.

— Flisni, agallarë, të gjithë do t'jë ktheni shpinët Madhërisë në këtë sahat të kobshëm?.. Më i moçmi i heqimëve, Shukri efendiu, bëri një çap përpara dhe i tha:

— S'është llafi se i kthejmë krahët Madhërisë, Allahu na e faltë, po shërimi i tij është tepër si

zorshëm. Unë jam motuar shumë dhe në këtë jetë s'di ç'kam thënë më tepër: marrëzira apo mënçurira. Po sa për këtë radhë, mendoj se tjetër shërim përvcq marrjes së Krujës nuk ka! — Në tendë ra një heshtje e rëndë si guri, si muret e k拉斯ë së nëmosur.

Vetëm Mehmeti bëri dy çape nga heqimi plak dhe i tha:

— Dëgjomëni, Shukri efendi. Sikur im atë të mos ndodhej në këtë ditë, gjuha jote do çuhej më dysh. Sikur nuk e di unë këtë farmak? Po juve aq ju bën·për mëkëmbësin e të madhit Zot! Sot vetë Allahu shkul mjekrën e tij për këto gjëma, kurse ti heqim më këput proçka.

— Allahu na ndritë trurin — foli kryeheqimi Murtai — do përpinqemi me të gjitha fuqitë, Zil-Ullah.

Mehmeti u nis më këmbë për tek Çakalloz Pasha. Ata ndenjën një copë herë ballë për ballë pa folur, pastaj Mehmeti filloj i pari.

— Punët s'i kemi mirë, efendi. Kjo duket sheshit. Zotrote e sheh që unë i kam të lidhura duart. Babai më kërkon t'i rri te koka dhe më këshillon. Më shkojnë drithma në trup kur kujtoj se këtu mund të humbas edhe tim atë edhe luftën. Ndaj ju them, Pasha se sidoqë të bëhet, veç marrjes së Krujës, nuk ka tjetër shtegdalje. Ti je i vetmi i besuar dhe i aftë për këtë detyrë. Këto desha të them, Pasha. Një trashëgim në rrëthana të tillë nuk do më duhej. Unë këtë s'do t'ja falja asnjeriut.

— Këto gjëra i dija edhe pa m'i thënë njeri, Zil-Ullah. Siç e sheh dhe unë për marrjen e Krujës po rropatem.

— S'më duhet përse rropate, Pasha, po më duhet përfundimi, Kruja. Dhe kur flet me mua, mos harro se njëkohësisht flet dhe me tim atë.

— Pikërisht kjo ma lidh gjuhën, Zil-Ullah — ja ktheu ashpër Pashai.

— Le të shpresojmë se një ditë do zgjidhet dhe ajo gjuha jote efendi, veç mos harro se kjo s'do të sjellë asgjë ugurbardhë — i tha plot inat Mehmeti dhe u largua pa ja hedhur sytë Pashait.

Ndërkohë kampi u drodh sërisht anembanë, sikur ky kamp të qe ngritur mbi një krater vullkani.

«Skënderbeu, xhindet, djajtë a perëndia e merr vesh se ç'po ngjante në këtë vend, foli Mehmeti i xhindosur me veten e tij.

\* \* \*

Kish nisur të thyhej nata kur Çakalloz Pasha u nis në ndjekje të Skënderbeut. Rreth 500 hapa përtej kampit, kohorta e Pashait u fut në ca shkrepëtë e nxirë e të frikshëm. Kalorësit bënин përparrë me zemër të ngrirë nga frika. Aty-këtu pengohej ndonjë kalë dhe zhurma e tij përshkonte me drithë gjithë kohortën. Sytë e ngulur në gjysmë errësirë më kot përpinqeshin të çbironin në të padukurën. Edhe kuajt nuk hingëllinin edhe kalorësit nuk flisin. Kjo kalori nuk i ngjante më një kohorte turke. Turqit gjithmonë e kishin ndjekur armikun me britma e ulërima, duke vringëllirë shpatat e përgjakura. Në këto raste shpotitë s'kishin të sotur, ndërsa hokatarët s'dinin ç'qe lodhja. Kjo kohortë i ngjante një xhenazeje të madhe. Shumë nga kalorësit u kishin zbritur kuajve dhe ecnin më këm-

bë. Po edhe kështu pengoheshin aty këtu në këta gurë të panumiërt. Në asnje vend s'kish kaq gurë se sa këtu. Vetëm Çakalloz Pasha çante përpara pa u lëkundur, i sigurtë se do t'ja mbërrinte qëllimit. Ai diç parandjente nga ky marshim i hesh-tur në mugëtirë i ushtrisë së tij, po prapë s'e bënte veten. Ai ish Çakalloz Pasha. Po kështu, kre-narë e të patrembur, marshonin dhe kalorësit përqark tij. Aty nga fundi i kohortës dy ulufe-xhinj kuvendonin me shoku shokun.

— Më duket punë e kotë — thoshte njëri zë. Tani vetëm të vdekurit dalin nga varret. Shpir-tëra të gjallë s'ka në këtë orë.

— Domethënë se varret i kemi të hapura, apo jo — ja ktheu zëri tjetër.

— C'flet ashtu mor zullap — ja priti i pari. — Mblidhe rradaken.

Dhe kohorta bënte përpara ngadalë, si asnje-herë tjetër. Pak më tej u futën në një pyll të den-dur e të frikshëm. Tani kalorësit mezi shquanin njëri tjetrin përmes drurëve të dendur. Dukej sikur pylli qe mbushur me hije. Në çast mbi gjethet e pemëve u drodh një erë e lehtë, të cilën pylli e përcolli me zhurmë tutje, si tingëllimë. Për njëherë kohorta e ndali hapin, sikur të kish marrë urdhër. Pritën dhe përgjuan ashtu një copë herë. Pylli i pabesë nuk po ndihej më.

— Përpara, kapedanë — oshëtiu zëri i Pasha Çakallozit. Megjithëse kohorta u tund nga vendi prapëseprapë zëri i Pashait tingëlloi këtë radhë më i kobshëm nga heshtja e pyllit. Yjet e pakta dridheshin atje sipër mbi kokat e turqve ndërsa hëna si një kulaç dylli kish hedhur përsipër një savan të hollë.

Pak më tej një derr i egër çau e doli përmes kohortës, duke tromaksur gjithë kalorësit. Sa pa e marrë mirë veten, një ulërimë ujku oshëtiu tejpërtej në pyllin e frikshëm.

Kalorësit duke kërkuar të ecnin sa më pranë njëri tjetrit, me njëren dorë shtrëngonin frerët, me tjetrën shpatat.

Marshimi vazhdonte po me atë çap të topitur. Degët dhe gjethet fshikullonin herë pas here kuaj e kalorës në ecje e sipër.

Pas pak kohorta doli nga pylli dhe hyri në një zallishte të gjerë. Këtu potkonjtë e kuajve filluan të kërcasin si në galop dhe në çast kalorësit u gjallëruan. Frika mbeti pas, njerëzit u shkundën dhe kërkonin të ndesheshin sa më parë me armikun.

Duke ecur kështu u futën në një gropë vigane, e cila qarkohej nga brigje e shkëmbinj. Ky vend këtu u ngjante turqve sikur shtrohej në fundin e xhehenemit. Dhe po aty u gjetën të rrethuar nga çdo anë prej Skënderbeut. Mbi ta binin gurë, zjarr, shigjeta e gjithëfarë sendesh të rënda e plagëhapëse. Pasha Çakallozi u ngrit mbi yzengjitet, zveshi pallën dhe urdhëroi: — Erdhi sahati, o muslimanë, që t'i shpiem Sulltanit trofenë e detyrës sonë. Hidhuni në sulm pér lavdinë otomane dhe mos u trëmbni nga pritat e një të pabesi.

Të qe shkulur ndonjë ortek, ndonjë majë mali apo ndonjë breg mbi lumë, s'do bënte dot atë zhurmë e bujë që bëri kohorta turke. Por punët u vinnin pisk e më pisk. Skënderbegasit dilnin tek s'i prisnje, sikur të mbinin nga dheu. Atë kohë turqit nuk u besuan syve. Nga balli i kalorisë arbërore, u shkëput një gjuhë e zjarrtë flake, e cila çau

përmes armiqve. Një ulufexhi po e sodiste këtë skenë si i gjysëmverbuar. Vetëm kur u gjet pranë rrëmetit, pa se Skënderbeu ish vetë. Ngriti pallën, po ajo i fluturoi mbi kokë si cingël. S'kuptoi se qysh u gjend ndën barkun e kalit, i shpëtuar përmrekulli nga një e ndarë më dysh. Palla e kryetrimit arbër çau kalin e tij dhe arriti gjer mbi çallmën fatmadhe. Ulufexhi<sup>1)</sup> u ngrit, po ç'të vërente?. Jo, vetëtima nuk i përshkon dot aq lehtë retë sa Skënderbeu kalorinë turke, duke lënë pas një brazdë gjaku. Kështu ai i ndau mespërmes dhe pastaj u kthye sërisht, duke mbjellë gjëmë e panik akoma më të madh! Me këtë vërshim ai e çoroditi ushtrinë armike. Ata s'kishin parë asnjë kapedan tjetër t'i shpërdoronte kështu, kaq me lehtësi. Kalorësit filluan t'i falen Allahut pas fjalës së profetit. Mjaft luftëtarë të rrahur në beteja s'besonin që Skënderbeu të ish njeri si gjithë të tjerët. Po kjo nuk vijoi gjatë. Pasha Çakallozi e përtëriti në çast dhe e ndezi sërisht betejën. Kështu Skënderbeu e pati të vështirë, të bashkohej prapë me të tijtë. Turqit e rrethuan nga çdo anë, po urdhëri ish të kapej i gjallë. Por ai s'permabahej dot. Më kot i hidhnin leqe e litarë nga çdo anë. Ai i bënte fërtele ç't'i dilte përpara. Rrethi sa vinte e ngushtohej. Shtigjet e shpëtimit u mbyllën. Kohorta turke u derdhë mbi kryetrimin si baticë. Ai ra nga kali, por palla e tij çante e ndante si më përpara. Më të djathëtë iu ndodh mburojë një trung lisi i tharë prej kohe. Rrethi kundër tij sa vinte e mbyllej. S'kish më asnjë shpëtim. Tani turqit po e shikonin nga afër

---

1) Ulufexhi — gradë ndër jeniçerë.

kapedanin, për të cilin besohej se qe i shenjtë. Tani ai u dukej si gjithë robërit e tjerë të Zotit. Vetëm sytë sikur i kish tepër të zjarrtë. Dhe ballin e kish të gjerë e të ndritur si ball prijesi të mënçur. Gjaku i rridhte nga e mëngjëra. Ai jepte goditje nga më të befasishmet. Dukej sikur sulmonte ai mbi turqit dhe jo armiqtë mbi 'të, kaq me guxim qëndronte. Ai njëkohësisht priste me zgjuarsi habitëse goditjet e tyre, sikur të kish katër palë sy. Pallat janiçere tani sa nuk e arrinin kokën e të paepurit.

Po ndërkohë palla e tij, si të kish marrë zjarrin e rrufeve, shkrepëtiu plot vringëllimë mbi kokat e turqve. Skënderbeu shpërtheu me një forcë mahnitëse duke hapur vijén e ngushtë të unazës së rrethimit. Turqit ishin shtrënguar aq shumë njëri pas tjetrit, saqë nuk hapeshin dot, me gjithë atë panik. Ai u ngjante turqve si një trup i zjarrtë, i paprekshëm, i pamposhtur. Përkundër Çakalloz Pasha drejtoi gjithë kohortën mbi princin arbëror, i sigurt se puna kish mbaruar plot lavdi! Veçse atë çast, s'u muar vesh se nga dolën gjithë ata arbër që rrethuan Skënderbeun me trupa e mburoja. Turqit mbetën pa gojë nga kjo e papritur. Që aty çdo gjë u kthyte kundra tyre. Skënderbeu i hypi sérish kalit dhe ajo pamje u preu krahet armiqve pa rinisur mirë dërma. Më në fund Pasha Çakallozi ndali krahuun dhe sokëlliu me atë zërin e tij që dridhte dhe gurët.

— Ku je futur, Skënderbe? Në je burrë, dil në mejdan të burrave e mos qëllo nga pusitë. Sot Allahu nuk na mbron dot të dyve: Pra eja, dhe kujt t'i ketë ardhur sahati udhaembarë i softë. Ish

një zë i fortë, por i dëshpëruar dhe me fare pak shpresë.

S'kaloi shumë dhe kryetrimi krenar gjegji.

— Kam kohë që nuk kam dalë në mejdan të burrave, Pasha. Vetëm se nuk desha që palla jote e ndritur të ndryshket para kohe, po zotrote e kërkove vetë këtë, ndaj s'kam si të veproj ndryshe. Në këto e sipër, i doli përpara Pashait. Dy luanë do ta kishin tepër zili këtë përpjekje. Ku shkelnin ata, tundej e gjëmonte dheu. Nga potkojtë e kuajve dilte flakë e kuqe, sa turqve u dukej sikur të qenë gjuhët e xhehenemit nga poshtë, që donin të përpinin të dy asllanët.

— S'ta kam mësuar keq pallën, Skënderbe, po sot do të t'i çmësoj të gjitha — tha në betejë e sipër Pashai.

— Kjo është punë që s'bëhet, efendi, — ja ktheu tjetri. Sikur nxënësit të mos dilnin përpara mësonjësve, bota do mbetej në vend.

— Këtë do ta shohim — ulëriti Pashai dhe qëllci me buzët e pallës. Po princi arbër nuk e zinte asnjë goditje. Skënderbeu qëllonte më rrallë, por me gjithë forcën e krahat. Pallën e rëndë, që me një goditje ndante më dysh kal' e kalorës bashkë, ai e luante si pendë stolie. Dukej sikur qe prerë vetëm e vetëm për të luajtur pallën me aq madhështi e hije. Pashai turk ngjante me një luan të egërsuar, që rreh të mbërthejë në kthetra ar-mikun. Ai, me një nervozizmë të pazakonshme dhe me një shpejtësi të çuditshme, kalonte pallën nga njëra dorë në tjetrën. Kuajt hidheshin e turfullonin sa tundnin malet rrreth e rrrotull. Skënderbeu s'mban-te mburojë fare. Gjoksi i tij i gjerë dhe i kërcyer,

i veshur me çelik, ngjante me një mburojë ngjyrë vetëtime. Dukej se asaj mburoje s'kishte q't'i bënte asnjë pallë në botë. Turqve u kish rastisur që pa-shain e tyre të ndritur ta shikonin në shumë dy-luftime. Kudo ai kish luftuar si asllan dhe kish ngadhënuar si dragua. Po këtë herë ai po luftonte sa tre luanë bashkë. Jo, bota akoma s'kish parë mirë se qysh mund të luftonin me pallë dy krye-burra. Aq shumë shkëndija lëshonin pallat e tyre, duke goditur njëra tjetrën, saqë dukej sikur do të merrte flakë në çast mjegulla e sabahut të jasemi-njtë. Përtej majave doli dielli si një trandafil i përgjjakur. Në çast panciri i Princit u ndez dhe llam-buriti nga rrezet e para. Gjoksi i tij shkëlqente tanë si një copë diell në mes të dy ushtrive. Po kaq diellore ngjante edhe palla e tij e zjarrtë. Be-teja dyshe vijonte po me atë tèrbim. As burrat as kuajt s'ndjenin të lodhur. Të dyja ushtritë sikur qenë mbërthyer në vend, të magjepsura nga ajo pamje kreshnike. Një jeniçer, tek vërente plot zi-li këtë betejë, luajti me bërryl shokun e tij në të mëngjér dhe i pëshpëriti. — Si thua efendi, a nuk ja vlen të rënditej e gjithë bota dhe të luftonte deri në vdekje pas këtyre dy kapedanëve, derisa të triumfonte njëri?

Shoku ja ktheu pa qejf. — Hë pér hë ja vlen që të fitojë Pashai. Çakallozin sikur e rrëmbeu më tepër ethja e betejës. Ai ish ngiritur në majat e këmbëve mbi yzengji dhe trupi i tij, si një vllas-tar, hidhej sa andej këndej mbi kalë, duke vrangë-llitur pallën e mprehtë. Përkundër Princi, i matur e me gjak të ftohtë, i priste goditjet aq i sigurt, sikur t'i kish llogaritur me kohë. Sytë e tij vete-



tinin plot dritë e hije me aq shumë shkëlqim, sa të merreshin mentë tek e shikoje. Turqve u dukej sikur të ishte ndonjë magjistar apo krei i xhehene-mit, që s'dihej qysh dhe pse kish dalë përmbi tokë, duke i shpëtuar ndëshkimit të zotit. Dielli sa vinte e çelej si ndonjë kurorë e përfshakur për ngadh-njimtarin e këtij mejdani të jashtzakonshëm.

— Sikur ashtu çuditërisht të ishin përpjekur diku jashtë kohës dhe hapësirës, Rustem Zalli<sup>1)</sup> me Herkulini<sup>2)</sup>, bota nuk do shihte dot një mrekulli të

1) Rustem Zalli — Heroi legjendar i botës myslymane, Personazhi kryesor i poemës madhështore «Shah-Nameja» e Firdusit.

2) Herkuli — biri i Zeusit, një nga heronjtë e legjendave greke.

atillë si ajo që po çfaqin këtu të dy kapedanët.  
— foli përsëri jeniçeri.

Çakalloz Pasha bëri aty një luftë madhështore. Ai i mohoi thinjat dhe vitet e tija me një lehtësi të paparë. Paska pra çaste që njeriu del përmbi veveten! Sikur rrufetë e Qiellit të shkrepëtinin gjithnjë me forcën e atyre pallave, Bota prej kohe do mbante erë shkrumb.

Turqit prisnin me zëmër të ngrirë, mbasi kurrë s'e kishin parë aq ngushtë Pashain. Më në fund kali i Skënderit u ngrit kaq lart mbi dy këmbët e pasme, saqë njerëzit thanë se do të fluturonte. Por ai nuk fluturoi. Vetëm palla e tij ra nga lart si një vetëtimë mbi Pashain dhe e ndau më dysh.

\* \* \*

Kryeheqimi Murtai jepte e merrte nëpër gjithfarë enësh. Zbrazte e mbushte dhe sérish zbrazte lloj-lloj lëngjesh. I duhej të fshinte oreçast djer-sët, që mos t'i kullonin mbi farmaqet. Përpiquej me gjithë shpirt të arrinte diçka që ish përmbi forcat dhe dijet e tij, diçka që as ai vetë nuk dinte ta përcaktonte mirë. Ka raste kur dashuria e verbër dhe sedra e moshës dalin përmbi arësyen. Kjo zakonisht zgjat pak ose përfundon në çmenduri. Murtai shpëtoi nga çmenduria, vetëm se nuk kish besim në atë që po bënte.

Tiranit nuk iu pre të përqartit edhe zjarmia s'po i binte. Djersët ja mbulonin pareshtur fytyrën e tij ngjyrë dylli...

Sultani, në përqart e sipër, kërkoi dy herë Çakalloz Pashën. Mehmeti s'dinte nga t'ja mbante

kësaj radhe. Qysh t'i fshihte Sulltanit të vërtetë? Aty afër sabahut tirani erdhi në vete dhe i pari njeri që kërkoi, ish Pasha Çakallozi. Mehmeti u mat të largohej, por sytë i dolën të pabesë. Murati u përpoq të ngruhej dhe me ndihmën e heqimëve u pështet mbi bërryl. Ai ja mbërtheu sytë e egërsuar të birit dhe ulëriti me një zë çuditërisht të fortë. — Ku e kini Çakalloz Pashën?

Mehmeti nuk kurisi të përgjigjej. Uli sytë pér tokë si një fajtor që pret dënimin.

— Mehmet, mos ka pësuar gjë Pasha Çakallozi? Fol, mor bir, qysh është puna!...

— Pashai i theu urdhërat tuaja, Madhëri, duke u futur në pritat e Skënderbeut të pabesë — tha me një frymë Mehmeti, sikur të qe çliruar nga një barrë e rëndë.

— Qysh?! — Kaq mundi të thotë Murati dhe u shemb në shtratin e tij me pupla.

Mehmeti mblodhi në tendën e tij kryen e ushtrisë otomane dhe filloj të përpunojë planin e sulmit vendimtar pér marrjen e Krujës. Ai tregohej aq energjik, aq i palodhur dhe aq i mprehtë saqë të gjithë i mahnitit. Të gjithë mendonin se Kruja këtë radhë i kish të shkurtëra hesapet. S'mbetej gjë përvëç sulmit, dhe Kruja do binte si lodër kartoni. Ballin ja kishin lagur ca bula djerse. Flokët e gjatë e të ndritur i qenë çpleksur nga çdo anë dhe ai shpesh u shkonte dorën, por ato sërisht i shpërndaheshin si më parë. Mehmeti i shikonte një nga një pashallarët me ngulm, sikur të kërkonte aty pér aty mendimin e tyre.

Të gjithë e kuptionin se pas Sulltan Muratit, perandorisë i vinte një zot fort i rreptë, i cili po të

kish fat, diç do arrinte: Vetëm me këtë bela Skënderbeun s'dihet se qysh do t'i shkonin punët. Veç kësaj s'duhej t'ja kishe zilinë, pushtetit ndën një monark të këtillë.

Në këto e sipër erdhi lajmi se Madhëria i kërkonte në tendën e tij, Mehmetin, Hysenin dhe dy pashallarë të tjerë. Murati u përmend shpejt. Fytyna e tij tepër e zbetë qe çelur disi dhe ai nuk ngjante aq i drobitur, sa dy orë më parë. Kur mbërriti aty Mehmeti vet' i katërt, Sulltani u tha:

— S'kam më asnje shpresë tek ju, o kapedanë. Tani urdhëroni t'i lini mënjanë pallat tuaja dhe t'i trohisni sa për të grirë lakra. Kruja do merret, por jo me ata topat tuaj që shurdhuan dynjanë. Sot Kruja do merret ndryshe. Unë kam prebatitur bakshishe për Uran Kontin. Atë do ta mbush me florinj e me xhevahire dhe Kruja do bëhet imja. Paskëtaj Skënderbeu do vijë të më bjerë më gjunjë.

Murati urdhëroi t'i binin aty pakot me bakshi-she për kapedanin e Krujës. Stolitë ishin aq fë shkëlqyera, aq të shumta, saqë pashallarëve u vetëtinë sytë. Kjo gjë nuk i shpëtoi Sulltanit. «Nuk ju kam faj, efendilerë. Kam Allahun shehit që s'ju mbetem borxhli. Këto do të kishin qenë tuajat të gjitha, po ju nuk qetë të zotë. Dhe ja, siç e shihni, të gjitha këto do t'i marrë e do t'i shpër-dorojë një arnaut. Kjo sepse s'u gjend asnje nga ju që t'i vinte gjoksin barrës. Se ju i dilni zot Krujës si evgjiti Dinit. Ti Hysen Pasha je i ngarkuar t'i dorëzosh bakshishet Uran Kontit dhe të flasësh gojarisht me të. Thuaji se do t'i jap çdo gradë e çdo pozitë që t'i dojë zemra. Ja, mbi gjithë këto

peshqeshe po shtoj dhe unazën time në shenjë nde-  
rimi. Unazë më të shtrenjtë nga kjo s'ka mbajtur  
asnje perandor deri më sot. — Dhe Sulltani hoqi  
nga gishti unazën e tij, për t'ja dhënë Hysenit. —  
Veç kini mendjen, Pasha, që karvani të mos i bje-  
rë në sy ushtrisë. Kaloni sa më fshehtas.

— Madhëri, përse nuk na lejuat ta provonim  
edhe njëherë shortin, pse i shpërdorci kështu gjithë  
këto pasuri? Mos vallë u dhimben turmat? Arnautët janë sa të dehur aq dhe të lodhur. Mbështetët  
ka ardhur sahati, Madhëri, na lejo të provojmë.  
Plani i sulmit është gati — kështu iu lut më gjunjë  
të jatit i biri.

— Ngrehu, Mehmet, ngrehu, mor bir! Edhe  
kështu do ta marr Krujën. Nuk është e para herë  
që floriri bën atë, që s'e bën dot palla.

— Nderi që po më huani sot, Madhëri, s'bën  
gjë tjetër veçse shton borxhin tim ndaj jush dhe  
perandorisë, — nisi falënderimet Hysen Pasha. —  
Mendja Juaj e ndritur e ka gjetur shumë bukur  
portën e kalasë këtë radhë. Vetëm për një gjë  
më ha frika, Madhëri, — shprehu dyshim Pashai.

— Përse kështu? — pyeti i shqetësuar Murati.

— Këta janë farë zbatharakësh, Madhëri, ndaj  
nuk ja dinë vlerën floririt. Kështu, zor se do pranojnë.  
Kuptojnë më mirë barotin se floririn.

— Gabohe, Hysen Pasha. Floriri ta mëson vetë  
vlerën e tij. Hajde, nisu tanë dhe të vaftë mbarë!

Karvan i Hysen Pashës, i ngarkuar me bak-  
shishet e Muratit, mori rrugën e kalasë, ndërsa  
Sulltani priste në tendën e tij, xhevapin e Uran  
Kontit. Dhe përgjigja nuk vonoi. Bile Hysen Pa-  
sha u kthyte më shpejt nga ç'kish pandehur Mu-

rati. Hysen Pasha mezi njihej. Çehrja e tij kish ndërruar aq sa s'bëhej më. As nga arkivolet një-rëzit nuk dalin ashtu. Dhe gjithë kjo në fare pak kohë.

— Falmëni, Madhëri! Allahut i ardhtë keq përmua. Por misionin nuk e përbusha dot, Madhëri. Këta zbatharakë nuk e njohin floririn, Madhëri. Këta duan vetëm shpatën kokës, Madhëri. Nuk njohin asnje vlerë tjetër veç zjarrit. Na tallën sa deshën dhe më në fund na përzunë me llafet më të fëlliqura, Madhëri...

Tirani dëgjonte i qetë në dukje, por, përbenda ziente dalngadalë. — S'e ke keq, Hysen Pasha. Të marrët dhe të mallkuarit s'njohin tjetër vlerë veç vdekjes. Pa më bini këtu planin e sulmit mbi kalanë — urdhëroi ai. Menjëherë karta u hap përrpara tij. Pashallarët e rrëthuan nga të katër anët. U mblohdhën aty në një qark gjithfarë mjekrash e çallmash nga të gjitha ngjyrat. Gjithkush përpiquej të merrte me mend i pari se ç'do të thoshte Sulltani dhe çfarë xhevapi do t'i pëlqente atij më tepër. Tiranin e rrëmbyen ethet e betejës. Tani nuk ngjante më me një të sëmurë. Bënte vërejtje nga më të papriturat.

— A e kuptioni, efendilerë, se topat këtu ku i kini lënë ju pak na hyjnë në punë? Dhe po t'i vendosim mbi këtë breg, gjylet do bien drejt e brenda në qytet. Dhe përsë harkëtarët të mos qepen majë këtij shkëmbi, që është po aq i lartë sa edhe muri i kalasë? — spjegonte Murati po-thuaj pa marrë frymë. Pastaj përsë kini zgjedhur këtë rreshtim për harkëtarët? Kështu i jepni front të gjerë goditjes armike. Prandaj ne paskemi gjithë

këta të vrarë ndër harkëtarët? Jo, trupat i vendosni në formën e majës së shigjetës. Kështu fronti vjen e zgjerohet sa më larg goditjes, sa më larg dëmit. Në rrithime si këto, ushtarët janë tepër të vyer. Duhen ruajtur dhe duhen prishur me vend.

Pashallarëve dhe gjeneralëve u perëndonin sytë nga dhëmbja dhe dëshpërimi. Sulltani parashtonte po ato plane, që ishin zënë disa herë në gojë, që ishin zbatuar një nga një, por nuk kishin dhënë asnjë përfundim.

Murati qe ngritur përgjysmë dhe fliste e fliste pa pushim, sikur po thoshte diçka krejt të re e të madhe. «Ja ku e kini Krujën, efendilerë, — thosh-



te ai. — Ja ku e kini. Dhe a e kuptoni se si do  
merret ajo? Ja kështu» dhe Murati mblođhi dorën  
që mbante kartën. Ai mbështolli në gishtërinjtë e  
tij planin e sulmit dhe sakaq u shtri papritur mbi  
shtratin e butë.

Në dorën e ngrirë karta e sulmit qe mbledhur  
shuk, për të mos u çpalosur më.

## FUND

483  
Tirazhi 10000 kopje      Format 70x100/32      Stash: 2204-65

---

Shtyp N.I.Sh. Shtypshkronjave «Mihal Duri» — Tiranë, 1967